



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 04. 03. 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu, Ramë Buja, Nexhat Daci, Ardian Gjini, Enis Kervan dhe Dragisa Miric.
Munguan: Lutfi Haziri dhe Ibrahim Gashi.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës;**
- 3. Formimi i Grupit të miqësisë Kosovë – Francë;**
- 4. Informatë nga pjesëmarrja e Delegacionit të Kuvendit në Konferencën e Kartës së Adriatikut;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

U miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar njëzëri.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës;**

Sabri Hamiti lidhur me Projektligjin për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, tha se në mbledhjen e kaluar kemi formuar grupin punues për shqyrtimin e këtij Projektligji. Kërkoj nga kryesuesi i grupit punues që ta njoftoi Komisionin mbi punën e bërë rreth shqyrtimit të Projektligjit.

Ramadan Avdiu njoftoi anëtarët e Komisionit se grupi punues është takuar dy herë dhe gjatë punës së tij ka kontaktuar edhe me sponsoruesin e Projektligjit.

Për Projektligjin për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, siç është thënë edhe gjatë leximit të parë në Kuvend, tha se ka shumë mangësi.

Grupi punues tha se ka bërë përpjekje që vërejtjet që kanë dalë nga leximi i parë t'i inkorporojë, duke filluar që nga preambula, dhe për ato i ofroi anëtarëve të Komisionit, tekstin me propozimin e amendamenteve.

Në vazhdim tha se, një pjesë e nenit për mënyrën e përdorimit të sallës VIP, kemi menduar të hiqet nga teksti dhe të rregullohet me vendim të veçantë të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në aspektin gjuhësor ka shumë mangësi, kryesisht përdorimi pavend i fjalëve. Po ashtu tha se ka të meta në caktimin e rangjeve, tek zonja e parë, tek caktimi i ditës së zisë, të cilat duhet të sqarohen.

Ardian Gjini propozoi që Komisioni të ketë një takim të posaçëm brenda javës vetëm për këtë Projektligj dhe të shqyrtohet nen për nen. Ky Projektligj përfshinë pjesë të shumta të aspekteve protokollare e asnjërin nuk e rregullon deri në fund. Projektligji nuk ka bosht thelbësor të protokollit. Komisioni ka edhe një mundësi nëse nuk do të mund ta riparojë Projektligjin dhe t'ia jap një bosht, mund t'i rekomandoj Kuvendit që Projektligji t'i kthehet sponsoruesit në ripunim.

Ramë Buja kërkoi që anëtarëve të Komisionit t'ju lejohet edhe pak kohë për ta analizuar më mirë Projektligjin dhe ta japin kontributin e tyre.

Nexhat Daci tha se protokollin nuk paraqet pozitë apo opozitë, por është fytyra e jashtme e shtetit prandaj duhet të nxjerrët një ligj që vërtetë i ka hije një shteti. Pasi Projektligji ka fituar shumicën e votave, tha se Komisioni duhet të bëjë përpjekje për amendamentim të mirë. Propozoi që grupit punues t'i jepet edhe pak kohë për punë, e nëse është e nevojshme t'i bashkëngjitet dhe ndonjë deputet, në mënyrë që të krijohet struktura e ligjit.

Ramadan Avdiu sqaroi se për hartimin e këtij Projektligji, është marrë për bazë ligji i Shqipërisë por me shkoputje, duke bërë përpjekje t'i përshtatet specifikave të Republikës Kosovës siç është rasti tek simbolet e shtetit.

Enis Kervan mendon se grupi punues ka punuar, por i nevojitet edhe pak kohë që të punojë, p.sh amendamenti 5 dhe 16 rregullojnë të njëjtën çështje, e po ashtu edhe tek amendamentimi lidhur me zonjën e parë.

Dragisha Miric propozoi që grupit punues ti jepet një afat shtesë, të paktën prej 10 ditësh që ta shqyrtoi Projektligjin më me hollësi.

Eqrem Kryeziu mendon se Projektligji tani pas këtij amendamentimi të parë që i është bërë nga grupi punues nuk mund të ketë shumë kontradikta, ndërsa disa elemente të tepërta mund të hiqen e po ashtu edhe gabimet gjuhësore të korrigjohen.

Xhavit Haliti lidhur me shqyrtimin e Projektligjit tha se do të ishte mirë që grupi punues ta gjejë një ekspert të lëmisë përkatëse për amendamentim sa më të mirë të Projektligjit dhe të sistemohen gjërat në bazë të Kushtetutës. Lidhur me marrjen e lejes nga Ministria e Punëve të Jashtme për kalim nëpër sallën VIP, mendon se boshti kryesor i shtetit duhet të caktohet me ligj, ndërsa pjesët e tjera të organizmave të shtetit mund të përcaktohen me vendime.

Nexhat Daci propozoi që grupit punues t'i jepet kohë shtesë për punë, të kyçet në grup punues edhe deputeti Ardian Gjini, dhe mundësisht të gjendet edhe një ekspert.

Komisioni pas diskutimeve nxori këtë

P e r f u n d i m

Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës të vazhdojë pas dy javëve, me vetëm këtë pikë të rendit të ditës.

Grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit, i bashkëngjitet deputeti Ardian Gjini dhe i lejohet mundësia grupit punues për angazhimin e një eksperti përkatës.

3. Formimi i Grupit të miqësisë Kosovë – Francë;

Sabri Hamiti njoftoi anëtarët e Komisionit se formimi i Grupit të miqësisë Kosovë-Francë është radhitur për shqyrtim pas shumë kontakteve që ka pasur me përfaqësues nga Asambleja Franceze, me përfaqësues frëng këtu, si dhe me ambasadorin frëng në Kosovë. Ekziston nevoja, mundësia dhe dëshira që Kuvendi ynë në këtë formë, që është formë e njohur e lidhjeve të parlamentareve të parlamenteve të ndryshme me njëri tjetrin, të krijohet ky grup. Për formimin e këtij grupi ekziston pajtimi dhe dëshira e dyanshme dhe janë plotësuar kushtet paraprake që Komisioni t'i rekomandoj Kryesisë ta miratoj këtë nismë.

Një interesim i tillë ekziston edhe për formimin e Grupit të miqësisë me Bundestagun Gjerman. Propozoi që Komisioni të rekomandoj miratimin e nismës për formimin e Grupit të miqësisë Kosovë-Francë në përbërje nga përfaqësues të grupeve parlamentare dhe deputetë që kanë afinitet varësisht nga interesat dhe aktivitetet që do të zhvillohen.

Anëtarët e Komisionit mbështetën këtë nismë, njëkohësisht propozuan që nisma të tilla të ndërmerren edhe me parlamentet e shteteve të tjera.

Komisioni pas diskutimeve nxori këtë

P e r f u n d i m

T'i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës ta miratojë nismën për formimin e Grupit të Miqësisë në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Asamblesë Nacionale të Francës.

Grupi i Miqësisë në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Asamblesë Nacionale të Francës të përbëhet fillimisht nga përfaqësues prej secilit grup parlamentar dhe nga një sekretar i caktuar për këtë Grup të Miqësisë me mundësi për plotësim varësisht nga interesat dhe aktivitetet që do të zhvillohen ndërmjet parlamenteve.

4. Informatë nga pjesëmarrja e Delegacionit të Kuvendit në Konferencën e Kartës së Adriatikut;

Sabri Hamiti informoi anëtarët e Komisionit se me ftesë të Kuvendit të Shqipërisë, një delegacion prej pesë anëtarësh, dy nga ky Komisioni dhe tre nga Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, morën pjesë në Konferencën e Kartës së Adriatikut (3+2), që u mbajt në Shqipëri.

Me qëllim të informimit më të hollësishëm rreth kësaj konference, tha se ju është shpërndarë Raporti.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit